



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 01 Dhjetor 2022

Nr: 213

Ora: 11.00

VENDIM

PËR

PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË GRAMSH, ME KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E PARTISË SË GJELBËR, ZJ. GERTA NURI MUÇA

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163 pika 7, 164 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 3602 prot., datë 12.09.2022, këshilli i bashkisë Gramsh, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Rigerta Hekuran Lumshi, propozuar nga subjekti politik Partia e Gjelbër.

Referuar nenit 164, paragrafi 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumëmemërore e Partisë së Gjelbër, për këshillin e bashkisë Gramsh, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 06, zj. Gerta Nuri Muça.

Me shkresën nr. 3269, prot., datë 26.09.2022, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në këshillin e bashkisë Gramsh, zj. Gerta Nuri Muça, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për

zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të subjektit Partia e Gjellbër, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 48 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Gerta Nuri Muça, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, me shkresën nr. 3340 prot., datë 06.10.2022 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 3339 prot., datë 06.10.2022 dhe shkresën nr.3447 prot., datë 28.10.2022, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për zj. Gerta Nuri Muça.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 10332/1 prot., datë 19.10.2022, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Gerta Nuri Muça, në këshillin e bashkisë Gramsh, ku konstatohet se me lidhjen e martesës ka marrë mbiemrin e bashkëshortit, duke e ndryshuar këtë përbërës nga “Fejzo” në “Muça”, sipas të cilit rezulton aktualisht.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 11639/1 prot., datë 11.10.2022, dhe shkresën nr. 12582/1 prot., datë 01.11.2022, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar zj. Gerta Nuri Muça, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Gerta Nuri Muça, në këshillin e bashkisë Gramsh nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Gramsh, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë së Gjellbër zj. Gerta Nuri Muça.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

